



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

**Nr.66**

**2005**

**5 shtator**

### P Ë R M B A J T J A

|   |  | Faqe |
|---|--|------|
| Dekret nr.4644<br>datë 1.9.2005           | Për thirrjen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.....   | 2357 |
| Dekret nr.4645<br>datë 3.9.2005           | Për emërimin e Kryeministrit.....  | 2357 |
| Vendim i KM<br>nr.562, datë 12.8.2005     | Për caktimin e funksioneve të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore në përbërje të këshillit administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.....   | 2358 |
| Udhëzim i MD<br>nr.2945/15,datë 17.8.2005 | “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.8044, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat e detyrimet mes tyre”..... | 2358 |

|   |  |      |
|---|--|------|
| Udhëzim i KQZ<br>nr.28, datë 23.8.2005  | Për një shtesë në udhëzimin nr.17, datë 6.6.2005 “Për përcaktimin e rregullave për deklarimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore, të subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të vitit 2005..... | 2361 |
| Udhëzim i KQZ<br>nr.29, datë 25.8.2005  | Për një shtesë në udhëzimin nr.5, datë 5.4.2005, i ndryshuar, “Për detyrat e Policisë së Shtetit dhe Forcave të Armatosura për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të vitit 2005”.....  | 2361 |
| Vendim i ERE<br>nr.37, datë 23.8.2005   | Për fillimin e procedurave të shqyrtimit.....  | 2362 |
| Vendim i ERE<br>nr.38, datë 23.8.2005   | Për mospranimin për shqyrtim të njoftimit për paraqitjen e aplikimit për ndërtimin dhe instalimin e H/C të ri Sasaj nga shoqëria Wonder sh.a.....  | 2362 |
| Vendim i KKRT<br>nr.356, datë 29.8.2005 | Për dhënie licence televizionit kabllor privat “Delvina”.....  | 2363 |

**DEKRET**  
**Nr. 4645, datë 3.9.2005**

**PËR EMËRIMIN E KRYEMINISTRIT**

Në mbështetje të nenit 96 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të shumicës parlamentare,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Zoti Sali Berisha emërohet në detyrën e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Alfred Moisiu**

**DEKRET**  
**Nr. 4644, datë 1.9.2005**

**PËR THIRRJEN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 93 dhe 67 pika 1 të Kushtetutës

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Mbledhja e parë e legjislaturës së 17-të të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë thirret ditën e premte, datë 2.9.2005, ora 18.<sup>00</sup>.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Alfred Moisiu**

**VENDIM**  
**Nr. 562, datë 12.8.2005**

**PËR CAKTIMIN E FUNKSIONEVE TË PËRFAQËSUESVE TË INSTITUCIONEVE  
SHTETËRORE NË PËRBËRJE TË KËSHILLIT ADMINISTRATIV TË INSTITUTIT TË  
SIGURIMEVE SHOQËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 72 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Funkcionet e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 72 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në përbërje të këshillit administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore të jenë:

|   |  |
|---|--|
| Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale | Ministër;  |
| Ministria e Financave                     | Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Buxhetit;                           |
| Ministria e Ekonomisë                     | Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Pronës Publike;                   |
| Ministria e Shëndetësisë                  | Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor; |
| Ministria e Drejtësisë                    | Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit;                        |
| Instituti i Statistikave                  | Drejtor i Përgjithshëm.  |

2. Vendimi nr.684, datë 13.12.2001 i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këshillin administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen institucionet e përmendura në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**UDHËZIM**  
**Nr. 2945/15, datë 17.8.2005**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 8044, DATË 2.12.2004 TË  
MINISTRIT TË DREJTËSISË “PËR PROCEDURAT E PARAQITJES SË KËRKESËS,  
CAKTIMIT TË ASISTENTIT PRANË NJË NOTERI, SI DHE TË DREJTAT E DETYRIMET  
MES TYRE”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të neneve 124 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 3 shkronja “c” të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

Në udhëzimin nr.8044, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes tyre” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pikat 1 dhe 2 të udhëzimit nr.8044, datë 2.12.2004 “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes tyre” shfuqizohen.

2. Pika 4 e udhëzimit nr.8044, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes tyre” ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“4. Personi i cili kërkon të qëndrojë si asistent pranë një noteri i drejtohet me kërkesë këtij të fundit.”.

3. Pika 5 e udhëzimit nr.8044, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes tyre” ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“5. Me marrjen e kërkesës, noteri duhet të kthejë përgjigje brenda 10 ditëve nga paraqitja e saj. Në rast se noteri pranon të asistohet nga personi i cili ka paraqitur kërkesën, brenda 15 ditëve nga lidhja e kontratës me asistentin, ai duhet të depozitojë në dhomën e noterisë ku ai është anëtar, në Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe në Ministrinë e Drejtësisë kopje të kontratës dhe të dokumentacionit ligjor që vërtetojnë plotësimin e kushteve të parashikuara në pikën 3 të udhëzimit nr.8044, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes tyre”.

4. Pika 6 e udhëzimit nr.8044, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes tyre” ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“6. Pas depozitimit të kontratës dhe të dokumentacionit ligjor sipas pikës 3 të këtij udhëzimi nga noteri, asistenti i drejtohet me kërkesë me shkrim Ministrisë së Drejtësisë për t’u regjistruar në regjistrin përkatës të asistentëve pranë kësaj ministrie. Kërkesës duhet t’i bashkëlidhen një certifikatë personale me fotografi e marrë jo më herët se tre muajt e fundit, si edhe një fotografi personale e tre muajve të fundit, me përmasa 4x4 centimetra;”.

5. Pikat 7 dhe 8 të udhëzimit nr.8044, datë 2.12.2004 “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes tyre” shfuqizohen.

6. Pika 9 e udhëzimit nr.8044, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes tyre” ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“9. Ministria e Drejtësisë bën regjistrimin në regjistrin e asistentëve pranë Ministrisë së Drejtësisë brenda 10 ditëve dhe njofton me shkrim asistentin dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë.

Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit, regjistron asistentin në regjistrin e asistentëve pranë saj.

Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, asistentit i kërkohet të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 10 ditëve. Në rast mosplotësimi të dokumentacionit brenda afatit të mësipërm, asistenti nuk regjistrohet në regjistrin përkatës pranë Ministrisë së Drejtësisë.”.

7. Pikat 10, 11, 12 dhe 13 të udhëzimit nr.8044, datë 2.12.2004 “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes tyre” shfuqizohen.

8. Pika 14 e udhëzimit nr.8044, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes tyre” ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“14. Në rast se gjatë kohës që personi qëndron si asistent, ndaj noterit jepet një nga masat disiplinore të parashikuara nga shkronjat “ç” dhe “d” të nenit 7 të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë” i ndryshuar, me ndërprerjen e asistencës, noteri është i detyruar ta pajisë asistentin me vlerësimin për periudhën e asistencës pranë tij. Një kopje e vlerësimit i dërgohet Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Me ndërprerjen e asistencës bëhen shënimet përkatëse pranë regjistrat të asistentëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe të Dhomës Kombëtare të Noterisë.”.

9. Pika 15 e udhëzimit nr.8044, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes tyre” ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“15. Në rast se gjatë periudhës së qëndrimit si asistent, asistenti mungon, koha e qëndrimit si asistent do të zgjatet për aq kohë sa ai ka munguar.

Noteri dhe asistenti janë të detyruar që në çdo rast të njoftojnë Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë për periudhën e mosparaqitjes. Ministria e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare e Noterisë bëjnë shënimet në regjistrat përkatës dhe pasqyrimet e nevojshme në dokumentacionin e dosjes personale të asistentit.”.

10. Pikat 16, 17 dhe 18 të udhëzimit nr.8044, datë 2.12.2004 “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes tyre” shfuqizohen.

11. Pika 19 e udhëzimit nr.8044, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes tyre” ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“19. Marrëdhëniet mes asistentit dhe noterit, përveç sa parashikohet në legjislationin në fuqi, rregullohen me kontratë të lidhur mes tyre.

Kontrata duhet të parashikojë detyrimin e noterit për të përfshirë asistentin në veprimtarinë e zyrës, si dhe për ta ndihmuar atë të mësojë si të ushtrorë profesionin e noterit, duke e këshilluar, orientuar e duke i shpjeguar me detaje proceset dhe interpretimin e dispozitave ligjore që zbatohen. Noteri është i detyruar të respektojë personalitetin e asistentit dhe etikën e komunikimit mes tyre.

Në kontratë duhet të parashikohet detyrimi i asistentit për të respektuar noterin dhe klientët dhe të sillt në mënyrë etike me ta, të përpiqet të mësojë sa më shumë e të kërkojë ndihmën e noterit për të kuptuar veprimtarinë noteriale dhe dispozitat ligjore mbi të cilat ajo mbështetet.

Kontrata duhet të parashikojë edhe orarin gjatë të cilit asistenti do të qëndrojë në zyrë, por në çdo rast jo më pak se 6 orë në ditë, si dhe të drejta e detyrime të tjera, të cilat kanë lidhje me veprimtarinë e zyrës dhe me procesin e mësimit të profesionit.

Kontrata duhet të përmbajë edhe detyrimin e noterit që, në rast transferimi, asistenti të vazhdojë periudhën e asistencës pranë tij. Në rast se asistenti, për arsye objektive, nuk mund të vazhdojë më asistencën pranë këtij noteri, atëherë ky i fundit duhet të bëjë vlerësimin për periudhën e asistencës pranë tij. Një kopje e vlerësimit i dërgohet Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Me ndërprerjen e asistencës bëhen shënimet përkatëse pranë regjistrat të asistentëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Mungesat pa arsye të asistentit përbëjnë shkak për zgjidhjen e kontratës.”.

12. Pika 20 e udhëzimit nr.8044, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes tyre” ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“20. Asistentët kanë të drejtë të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet noteriale që kryen zyra dhe nëse dëshirojnë mund të ndihmojnë noterin në përgatitjen e akteve, por nuk kanë të drejtë të kërkojnë pagesë për këtë, përveç rastit kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Asistenti nuk ka të drejtë të firmosë apo vulosë dokumente, si dhe të bëjë shënimet përkatëse në regjistrat noterialë.”.

13. Pika 22 e udhëzimit nr.8044, datë 2.12.2004 “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes tyre” shfuqizohet.

14. Pika 24 e udhëzimit nr.8044, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes

tyre” ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“24. Në përfundim të periudhës 2-vjeçare, asistenti i pajisur me certifikatë nga Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe që plotëson kushtet e tjera të përcaktuara në nenin 2 të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, ka të drejtë të marrë pjesë në konkurrimet e organizuara për ushtrimin e profesionit të noterit në plotësimin e vendeve vakante.”.

15. Pika 25 e udhëzimit nr.8044, datë 2.12.2004 “Për procedurat e paraqitjes së kërkesës, caktimit të asistentit pranë një noteri, si dhe të drejtat dhe detyrimet mes tyre” shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË  
Fatmir Xhafaj

**UDHËZIM**  
**Nr. 28, datë 23.8.2005**

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 6.6.2005 PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR DEKLARIMIN E SHPENZIMEVE TË FUSHATËS ZGJEDHORE, TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË VITIT 2005**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 6.6.2005 në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 144 dhe nenit 145/1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZON:

Neni 1

Në udhëzimin nr.17, datë 6.6.2005, pas nenit 13, shtohet neni 13/1 me këtë përmbajtje:  
“Dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen edhe në rastin e zgjedhjeve të pjesshme për Kuvendin e Shqipërisë dhe/ose zgjedhjeve të pjesshme për organet e qeverisjes vendore.”.

Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**UDHËZIM**  
**Nr. 29, datë 25.8.2005**

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.5, DATË 5.4.2005, I NDRYSHUAR, “PËR DETYRAT E POLICISË SË SHTETIT DHE FORCAVE TË ARMATOSURAS PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË VITIT 2005”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 25.8.2005 në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 104, 105 pika 2, nenit 116, nenit 109/1, pika 2 dhe 3 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neneve 60/a deri 60/ç të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar,

UDHËZON:

## Neni 1

Në udhëzimin nr.5, datë 5.4.2005 “Për detyrat e Policisë së Shtetit dhe Forcave të Armatosura për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të vitit 2005”, ndryshuar me udhëzimin nr.18, datë 10.6.2005, pas nenit 10, shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

“Dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen edhe në rastin e zgjedhjeve të pjesshme për Kuvendin e Shqipërisë dhe zgjedhjeve të pjesshme për organet e qeverisjes vendore.”.

## Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

### **VENDIM**

**Nr. 37, datë 23.8.2005**

#### **PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 9, neni 13 pika 1, gjerat ç dhe dh, neni 15 pika 1 dhe neni 45 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s,” me ndryshimet përkatëse, neni 11; Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 23.8.2005, pasi shqyrtoi aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga shoqëria KESH sh.a. për vitin 2006; aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga shoqëria “Favina” sh.p.k.,

#### VENDOSI :

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga shoqëria KESH sh.a. për vitin 2006.
2. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga shoqëria “Favina” sh.p.k.
3. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

### **VENDIM**

**Nr. 38, datë 23.8.2005**

#### **PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË NJOFTIMIT PËR PARAQITJEN E APLIKIMIT PËR NDËRTIMIN DHE INSTALIMIN E H/C TË RI SASAJ NGA SHOQËRIA WONDER SHA**

Në mbështetje të nenit 9, neni 13 pika 1, gjerat ç dhe dh, neni 15 pika 1 dhe neni 45 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të nenit 11 pika 2 të ligjit nr.7973, datë 25.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” me ndryshimet përkatëse, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s” me

ndryshimet përkatëse, neni 11; Bordi i Komisionerëve të ERE – s, në mbledhjen e tij të datës 23.8.2005, pasi shqyrtoi njoftimin për paraqitjen e aplikimit për ndërtimin dhe instalimin e H/C të ri Sasaj nga shoqëria Wonder sh.a.,

**VENDOSI :**

1. Për mospranimin për shqyrtim të njoftimit për paraqitjen e aplikimit për ndërtimin dhe instalimin e H/C të ri Sasaj nga shoqëria Wonder sh.a., pasi njoftimi dhe aplikimi duhet të kryhen nga shoqëria koncesionare në zbatim të nenit 4 të marrëveshjes së koncesionit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.501, datë 23.7.2004.

2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe i Marrëdhënieve me Publikun dhe Departamenti i Licencave dhe i Monitorimit të njoftojnë shoqërinë Wonder sh.a. dhe ta informojnë atë për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm nga shoqëria koncesionare, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S  
Pjetër Dema**

**VENDIM**

**Nr. 356, datë 29.8.2005**

**PËR DHËNIE LICENCE**

**PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT**

**“DELVINA”**

**SUBJEKTIT: Z. ADRIATIK BAJRAMI**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.351, datë 10.6.2005, Këshilli i Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

**VENDOSI:**

1. T’i japë subjektit fizik, z. Adriatik Bajrami, licencën, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen strukturat programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
Halil Lalaj**

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".  
Tel: 042 555 63; 267 468

**Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:**

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

**BOTIMET:**

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

**DOLI NGA SHTYPI:**

**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004**  
**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004**

Doli nga shtypi më 5.9.2005

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 4300 copë | Formati: 60x88/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2005

Çmimi: 50 lekë